



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 724/8 prot.

Datë 09.04.2025

V E N D I M
Nr. 455/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “K.M.K” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur - punë” me nr. REF-26563-10-28-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës “Pusi i Mezinit”, me fond limit 49,744,339.25 (dyzetë e nëntë million e shtatëqind e dyzetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e nëntë.25) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “K.M.K” SHPK me NIPT L78223801E dhe adresë Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Vlorë me adresë Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu”.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “Sterkaj” SHPK me NIPT J68310708M dhe adresë Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 5, Blv. "Bajram Curri", mbrapa pallateve Agimi, Pallati 7/1B, Kati 2

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.10.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur - punë” me nr. REF-26563-10-28-2024, me objekt: “*Rikonstruksioni i rrugës “Pusi i Mezinë”*”, me fond limit 49,744,339.25 (dyzetë e nëntë million e shtatëqind e dyzetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e nëntë.25) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 13.11.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 17.12.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “SHKELQIMI 07” shpk, vlera 32,000,000.00 lekë pa tvsh I Skualifikuar
2. K.M.K shpk, vlera 33,790,600.00 lekë pa tvsh I Skualifikuar
3. MELA shpk 34,080,500.00 lekë pa tvsh I Skualifikuar
4. 2 N shpk 39,984,500.00 lekë pa tvsh I Skualifikuar
5. STERKAJ shpk 42,276,050.00 lekë pa tvsh I Kualifikuar
6. BOE RSM COMPANY" sh.p.k& “RSM CONSTRUCTION” sh.p.k. & “DESARET COMPANY” sh.p.k., vlera 46,920,006 lekë pa tvsh I Skualifikuar
7. B.O.E B93 II shpk & GRAMA shpk 48,576,040.00 lekë pa tvsh I Kualifikuar
8. ASI-2A CO shpk 49,464,750.00 lekë pa tvsh I Skualifikuar

II.3.1. Operatori ekonomik “K.M.K” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyet si më poshtë:
“OE, K.M.K sh.p.k me NIPT :L78223801E nuk ka dorëzuar dokumentacionin e plote fizik te deklaruar në sistemin APP.

1. Dokumentacioni ekonomik ku përfshihen: sigurim oferte, oferta, grafiku, ekstrakte historik+ekstrakt I thjeshte I regjistrit tregtar, vërtetim statusi aktiv/pasiv, OSSHE, gjyqësor, vertetime Kontribute+listepagesa sigurime shoqërore, bilance, vërtetim xhiro – mungojne.
2. Liçenca + ISO
3. Oferta ekonomike +Shtojca e vete deklarimit + sigurimi I ofertes+deklarata te ndryshme nga gjykata, prokuroria, APP Referuar Neni 26, pika 2 dhe 6 të VKM Nr.285 dt. 19.05.2021 (I ndryshuar) mosparaqitja e saktë dhe e plotë e dokumentacionit brenda afatit të përcaktuar përbën kusht për skualifikim.”

II.4. Në datën 10.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 13, datë 17.03.2025, ku është shpallur fitues OE “STERKAJ” shpk.

II.5. Në datën 13.03.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5138 dhe me nr. 724/2025 prot., datë 17.03.2025 e operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “K.M.K” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar, të parashtruara në ankesën me nr. 724 prot., datë 17.03.2025.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 724/1 prot., datë 17.03.2025, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK, që ka parashtruar me anë të ankesës me nr. 724/2025 prot., datë 17.03.2025.

II.7. Me shkresën nr. 4871 prot., datë 28.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 724/2 prot., datë 01.04.2025, me objekt “Vendim”, autoriteti kontraktor ka dërguar me anë të sistemit elektronik, informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues ku konstatohet, se ka vendosur pranimin e pjesshëm të saj duke argumentuar:

“KSHA....

VLERËSON SE:

15. Operatori Ekonomik që ka regjistruar ankimin, konkretisht K.M.K sh.p.k, legjitimohet racione personae t'i drejtohet Autoritetit Kontraktor.

16. Ankimi është regjistruar brenda afatit ligjor, ndaj edhe legjitimohet racione temporis. Gjithashtu rezulton se ankimi është publikuar ne rregjistrin e ankesave.

17. Komisioni I Vlerësimit të Ofertave me proçesverbalin e rivlerësimit me Nr.16306/19 Prot., datë 03.02.2025, ka arsyetuar në lidhje me shkaqet e skualifikimit:

-Operatori ekonomik K.M.K sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor me Nr.418 prot, datë 13.01.2024, por dosja e dorëzuar paraget mangësi të licencave, çertifikateve ISO, dokumentave ekonomik (xhiro vjetore, bilance, listëpagesa, ekstrakt, vërtetime, deklarata, oferta ekonomike, sigurim oferte, etj), për keto arsye KVO e shpall te pavlefshme këtë ofertë, duke vijuar me rivlerësimin e procedures ahe skualifikimin e OE

18. Në vlerësim të KSHA është e paqarte KVO në arsyetimin ... ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor me Nr.418 prot, datë 13.01.2024, por dosja e dorëzuar paraget mangesi të licencave, çertifikateve ISO, dokumentave ekonomik sigurim oferte, etj..

19. Duke mbajtur në konsiderat shkaqet e ankesës si dhe për te kuptuar drejte arsyetimin e mbajtur nga KVO për skualifikimin e OE ankues, KSHA me shkresën Nr.4796 datë 27.03.2025 kërkoj informacion nga anëtarët e KVO duke drejtur pyetjet si më poshtë:

20.Të na bëni me dije nëse dokumentacioni i cili pershkruhet ne shkresën percjellëse me Nr.418 prot., datë 13.01.2024, administruar nga ana juaj, dhe që perbënë shkak për vendimin e skualifikimit të OE, është i plotë në kuptimin fizik/lëndor sipas të dhënave në shkresën percjellëse?

21.Nëse dokumentacioni ka qene i plotë sipas pikës 1, OE do të duhej te plotësonte edhe dokumentat e cituar ne mënyrë eksplicite ne arsyetimin e vendimit tuaj?

22.Ne varësi te situates faktike, a keni komunikuar me OE për plotësimin e këtij dokumentacioni? Ne ç'farë forme komunikimi dhe me c' far mjeti komunikimi?

23.KVO në shkresën Nr4796/1 datë 27.03.2025 ka informuar KSHA-në lidhur me dokumentacionin fizik "Për rikonstruksionin e rruges "Pusi I Mezinis" me fond limit: 49,744,339.25 Lekë pa TVSH, të dorëzuar nga Operatori Ekonomik K.M.K sh.pk me Nipt L78223801E, në date 13.01.2025, me Nr.418 Prot., nuk eshte i plotë, sipas të dhënave në shkresën percjellëse. Operatori Ekonomik ka deklaruar në shkresën percjellëse 575 faqe të dorëzuara kur ndërkohë fizikisht janë dorëzuar 452 faqe.

24.Operatori Ekonomik K.M.K sh.pk me Nipt L78223801E, është njoftuar nëpërmjet mjetit të komunikimit elektronik, telefon celular, si çdo mjet elektronik i mundshëm.

25.Lidhur me sa më sipër KSHA vlerëson se KVO mund te kishte përdorur komunikimin me Operatorin Ekonomik në kuptim të pikës 1 të nenit 17, nenit 4 pika 29 të ligjit nr.162 "Për Prokurimin Publik", nenit 26 pika 7 të të VKM-së Nr.285 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

26.Duke u njohur me shkresën e sipërcituar KSHA, vlereson se kjo shkresë percjellëse permban elementët e domosdoshëm për garantuar sigurinë juridike, te cilët janë numri I Protokolit, data që kjo shkresë ka mar ne insitucionin e Bashkisë Vlorë, vulën e sekretarisë së institucionit, e cila dokumenton lidhjen me kartelen shoqëruese, të nënshkruar nga titullari I institucionit. Gjithashtu kjo shkresë permban edhe elementët indetifikues të Operatorit Ekonomik shogëria K.M.K sh.p.k, të cilët jane: numri I protokollit, data, vula e shoqërise dhe nënshkrimit I administratorit te shoqërisë. Duke mar për baze te gjithë këto elemnte indetifikues të shkresës, kerkuar nga legjislacioni ne fuqi si dhe duke patur ne vëmendje nenin 80 pika 3 të ligjit 44/2015 "Kodi I Procedurave Administrative I Republikës së Shqipërisë".Kuptimi dhe mjetet e kerkimit të provës;

3. Faktet tashme të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova te metejshme.

27.Për më tepër referuar pikës 2 të nenit 8 të Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 23 datë 29.03.2024 protokolluar me Nr. 4732 Prot, datë 29.03.2025 Për Miratimin e "Rregullores Për Krijimin, Administrimin, Përpunimin dhe Shërbimin e Dokumentave në Bashkinë Vlorë" Dokumenti Hyrës; 2. Punonjësit e protokollit kontrollojnë dokumentet hyrës dhe bëjnë evidentimin e tyre në regjistrin e korespondences Mod. 1. Dokumentat që kanë ardhur gabimisht, që kanë mungesa apo nuk plotësojnë kërkesat, i kthehen dërguesit ose dërgohen në destinacion përkatës.

28.Sa më sipër, bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, zyrtarët e ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSËM

Pranimin e pjesshem te ankeses te paraqitur nga operatori ekonomik për ridërgimin në Autoritetin Kontraktor të dokumentacionit që Operatori Ekonomik ka disponuar deri më datën 13.01.2025, me qëllim vazhdimin e procedurave ligjore nga Komisioni I Vlerësimit të Ofertave.”

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 4871 prot., datë 28.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 724/3 prot., datë 07.04.2025, me objekt “Vendim” autoriteti kontraktor ka dërguar me shërbim postar, informacionin më sipër mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.9. Me shkresën nr. 724/4 prot., datë 07.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua autoritetit kontraktor Bashkisë Vlorë, që të dërgojë dokumentacionin e plotë fizik të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK, të njehsuar me origjinalin dhe të numerizuara nga ana e autoritetit kontraktor.

II.10. Me datë 08.04.2025 përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) i cili u protokollua me tonën me nr. 724/5 prot., datë 09.04.2025 autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacionin fizik të paraqitur nga ankimuesi “K.M.K” SHPK në autoritet kontraktor.

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “K.M.K” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të KVO për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 4871 prot., datë 28.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 724/2 prot., datë 01.04.2025, me objekt “Vendim”, autoriteti kontraktor ka dërguar me anë të sistemit elektronik, informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues ku konstatohet, se ka vendosur pranimin e pjesshëm të saj duke argumentuar:

“KSHA....

VLERËSON SE:

17. Operatori Ekonomik që ka regjistruar ankimin, konkretisht K.M.K sh.p.k, legjitimohet *ratione personae* t'i drejtohet Autoritetit Kontraktor.

18. Ankimi është regjistruar brenda afatit ligjor, ndaj edhe legjitimohet *ratione temporis*. Gjithashtu rezulton se ankimi është publikuar në regjistrin e ankesave.

17.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave me procesverbalin e rivlerësimit me Nr.16306/19 Prot., datë 03.02.2025, ka arsyetuar në lidhje me shkaqet e skualifikimit:

-Operatori ekonomik K.M.K sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor me Nr.418 prot, datë 13.01.2024, por dosja e dorëzuar paraqet mangësi të licencave, çertifikateve ISO, dokumentave ekonomik (xhiro vjetore, bilance, listëpagesa, ekstrakt, vërtetime, deklarata, oferta ekonomike, sigurim oferte, etj), për keto arsye KVO e shpall te pavlefshme këtë ofertë, duke vijuar me rivlerësimin e procedurës ahe skualifikimin e OE

20. Në vlerësim të KSHA është e paqarte KVO në arsyetimin ... ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar pranë autoritetit kontraktor me Nr.418 prot, datë 13.01.2024, por dosja e dorëzuar paraqet mangësi të licencave, çertifikateve ISO, dokumentave ekonomik sigurim oferte, etj..

21. Duke mbajtur në konsiderat shkaqet e ankesës si dhe për te kuptuar drejte arsyetimin e mbajtur nga KVO për skualifikimin e OE ankues, KSHA me shkresën Nr.4796 datë 27.03.2026 kërkoj informacion nga anëtarët e KVO duke drejtur pyetjet si më poshtë:

20. Të na bëni me dije nëse dokumentacioni i cili pershkruhet ne shkresën perçjellëse me Nr.418 prot., datë 13.01.2024, administruar nga ana juaj, dhe që perbënë shkak për vendimin e skualifikimit të OE, është i plotë në kuptimin fizik/lëndor sipas të dhënave në shkresën perçjellëse?

21. Nëse dokumentacioni ka qene i plotë sipas pikës 1, OE do të duhej të plotësonte edhe dokumentat e cituar në mënyrë eksplicite në arsyetimin e vendimit tuaj?

22. Në varësi të situatës faktike, a keni komunikuar me OE për plotësimin e këtij dokumentacioni? Në ç'farë forme komunikimi dhe me ç'farë mjeti komunikimi?

23. KVO në shkresën Nr.4796/1 datë 27.03.2025 ka informuar KSHA-në lidhur me dokumentacionin fizik "Për rikonstruksionin e rruges "Pusi I Mezinis" me fond limit: 49,744,339.25 Lekë pa TVSH, të dorëzuar nga Operatori Ekonomik K.M.K sh.p.k me Nipt L78223801E, në datë 13.01.2025, me Nr.418 Prot., nuk është i plotë, sipas të dhënave në shkresën perçjellëse. Operatori Ekonomik ka deklaruar në shkresën perçjellëse 575 faqe të dorëzuara kur ndërkohë fizikisht janë dorëzuar 452 faqe.

24. Operatori Ekonomik K.M.K sh.p.k me Nipt L78223801E, është njoftuar nëpërmjet mjetit të komunikimit elektronik, telefon celular, si çdo mjet elektronik i mundshëm.

25. Lidhur me sa më sipër KSHA vlerëson se KVO mund të kishte përdorur komunikimin me Operatorin Ekonomik në kuptim të pikës 1 të nenit 17, nenit 4 pika 29 të ligjit nr.162 "Për Prokurimin Publik", nenit 26 pika 7 të të VKM-së Nr.285 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

26. Duke u njohur me shkresën e sipërcituar KSHA, vlerëson se kjo shkresë perçjellëse përmban elementët e domosdoshëm për garantuar sigurinë juridike, të cilët janë numri i Protokollit, data që kjo shkresë ka marrë në institucionin e Bashkisë Vlorë, vulën e sekretarisë së institucionit, e cila dokumenton lidhjen me kartelen shoqëruese, të nënshkruar nga titullari i institucionit. Gjithashtu kjo shkresë përmban edhe elementët identifikues të Operatorit Ekonomik shogëria K.M.K sh.p.k, të cilët janë: numri i protokollit, data, vula e shoqërisë dhe nënshkrimi i administratorit të shoqërisë. Duke marrë për bazë të gjithë këto elemente identifikues të shkresës, kerkuar nga legjislacioni në fuqi si dhe duke marrë në vëmendje nenin 80 pika 3 të ligjit 44/2015 "Kodi I Procedurave Administrative I Republikës së Shqipërisë". Kuptimi dhe mjetet e kerkimit të provës;

3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.

27. Për më tepër referuar pikës 2 të nenit 8 të Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 23 datë 29.03.2024 protokolluar me Nr. 4732 Prot, datë 29.03.2025 Për Miratimin e "Rregullores Për Krijimin, Administrimin, Përpunimin dhe Shërbimin e Dokumentave në Bashkinë Vlorë"

Dokumenti Hyrës; 2. Punonjësit e protokollit kontrollojnë dokumentet hyrës dhe bëjnë evidentimin e tyre në regjistrin e korespondences Mod. 1. Dokumentat që kanë ardhur gabimisht, që kanë mungesa apo nuk plotësojnë kërkesat, i kthehen dërguesit ose dërgohen në destinacion përkatës.

28. Sa më sipër, bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, zyrtarët e ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSËM

Pranimin e pjesshem të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik për ridërgimin në Autoritetin Kontraktor të dokumentacionit që Operatori Ekonomik ka disponuar deri më datën 13.01.2025, me qëllim vazhdimin e procedurave ligjore nga Komisioni I Vlerësimit të Ofertave."

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: "Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera".

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i cili parashikon shprehimisht se : "Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës

1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ konkretisht vendimit të KSHA për trajtimin e ankesës rezulton se kjo e fundit në vendimin e saj ka evidentuar se KVO e autoritetit kontraktor ka patur paqartësi në vendimmarrje si dhe në veprimet proceduriale të kryera nga ana e saj dhe për këtë fakt i është drejtuar me pyetje konkrete në lidhje me veprimet proceduriale dhe administrimin e dokumentacionit të ankimuesit. Pas informacionit të KVO të autoritetit kontraktor, KSHA ka vendosur: “Pranimin e pjesshem te ankeses te paraqitur nga operatori ekonomik për ridërgimin në Autoritetin Kontraktor të dokumentacionit qe Operatori Ekonomik ka disponuar deri më datën 13.01.2025, me qëllim vazhdimin e procedurave ligjore nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.” Në këto kushte duke qenë se KSHA e autoritetit kontraktor ka vendosur për ridërgimin në autoritet kontraktor të dokumentacionit që ankimuesi ka disponuar deri me datë 13.01.2025 (data e paraqitjes së dokumenteve nga ankimuesi në autoritet kontraktor) me qëllim vazhdimin e procedurave ligjore nga KVO dhe për sa kohë nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar bazuar në nenin 115 të ligjit të sipërcituar, KPP do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “K.M.K” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur - punë” me nr. REF-26563-10-28-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës “Pusi i Mezinit”, me fond limit 49,744,339.25 (dyzetë e nëntë million e shtatëqind e dyzetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e nëntë.25) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike me datë 01.04.2025 përmes shkresës nr.4871 prot., datë 28.03.2025 protokolluar me tonën me nr. 724/2 prot., datë 01.04.2025.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “K.M.K” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Gjergj Mersini	Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

